

Tirane me, 1 Nentor 2006

Ftese per Takim Koordinues

[Per nismat ne drejtim ndalimit te punes se femijeve si dhe te pergatitjeve per 20 Nentorin \(17 vjetorin e Konventes per te Drejtat e Femijeve\),](#)

Te nderuar miq dhe kolege,

Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi – CRCA ne kuader te nismave te saj ne per te drejtat e femijeve ne Shqiperi, organizon nje Takim Koordinues me perfaqesues te organizatave jo-qeveritare qe punojne me/ per femijet ne Shqiperi.

Qellimi i takimit eshte koordinimi i programeve dhe aktivitetet te OJF-ve per sa me poshte:

1. Lidhur me ngritjen e grupit te punes per ndryshimet ne legjislacion per ndalimin e punes se femijeve ne Shqiperi (rishikimi i legjislacionit dhe propozimi i ndryshimeve ligjore).
2. Duke gene se me daten 20 Nentor 2006 eshte 17-vjetori i aprovimit te Konventes se te Drejtave te Femijeve nga OKB, synojme qe ne kete takim te koordinojme dhe planifikojme aktivitetet qe mund te organizojme se bashku me rastin e pervjetorit te kesaj dite te rendesishme per te gjitha OJF-te qe punojne per femijet ne Shqiperi.

Une kam kenaqesine qe t'ju ftoj te merrni pjese ne kete takim. Ne kete takim jane te ftuar te marrin pjese te gjitha organizatat qe punojne per/me femijet dhe ato qe kane si qellim eliminimin e punes se femijeve.

Takimi do te zhvillohet me date 7 Nentor 2006, dite e Marte, ora 11.00, ne mjediset e Qendres per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi – CRCA. Me poshte keni edhe Axhenden e takimit.

Jeni te lutur te konfirmoni pjesmarrjen tuaj brenda dates 6 Nentor 2006, ora 17.00.

Singerisht

Altin Hazizaj

Drejtor i CRCA

AXHENDA E TAKIM KOORDINUES

7 Nentor 2006

11.00- 11.15 Regjistrimi dhe prezantimi i pjesmarresve

11.15- 11.30 Prezantimi i programeve te Organizatave/ Institucioneve pjesmarrese

11.30-11.45 Diskutime rreth ngritjes se nje Grupi Pune per rishikimin e Legjislacionit Kombetar per Punen e Femijeve

11.45- 12.00 Diskutime rreth mundesise se realizimit te nje Seance Degjimore ne Parlament rreth Fenomenit te Punes se Femijeve (ne date 20 Nentor).

12.00- 12.30 Diskutime rreth organizimit, planifikimit dhe koordinimit te aktiviteve me rastin e 20 Nentorit, pervjetorit te 17-te te miratimit te KDF-se nga OKB.

12.30 Mbyllja e takimit

Per cdo informacion kontaktoni:

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa fushave te Tenisit, Kati 3, Tirane

Tel/fax: 04 242264

E-mail: crca@crca.org.al
